

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 01/11 /2024 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

**SAIMIR PROJ**, i datelindjes 31/05/2002, i lindur dhe banues ne Sarande, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. K20531069U , leshuar nga MB me date 31/12/2019, i cili me vullnet të lire të plete e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin **LINA BOAT TRIPS** shpk.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

#### Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me perjegjesi të kufizuar është **LINA BOAT TRIPS** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

#### Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **LINA BOAT TRIPS** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është perjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **LINA BOAT TRIPS** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

Selia

**Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Sarande, Lagjja Nr.1, Godina me Nr.Pasurie 7/435, Zona Kadastrale 8641.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

#### Neni 4

Objekti i veprimtarise

**Operator turistik, sherbime turistike ne det. Shitetje me Varke Turistike te pushuesve.**

#### Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

### KREU II

KAPITALI

#### Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **10.000** lekë.

Kapitali i shoqerise eshte **10.000** leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Z. **SAIMIR PROJ**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **10.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10.000 Leke**, eshte paguar nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontributet në shërbime.

Ortaku i vetem themelues per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

#### KREU II

##### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organ i Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

##### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator i vetem.

**SAIMIR PROJ**, i datelindjes 31/05/2002, i lindur dhe banues ne Sarande, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. K20531069U , leshuar nga MB me date 31/12/2019.

Emerimi i administratorit eshte me një afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në

çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të jatin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilën eshte krijuar siç mund të jene

- a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b.Ne një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"
- c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te pote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 14

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permbytje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **LINA BOAT TRIPS** shpk, nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

## **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

**SAIMIR PROJ**



**ADMINISTRATORI**

**SAIMIR PROJ**

